



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 55/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ne përbërje te gjyqtarëve, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nenad Llaziq anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Iniciativës politike “Kosova Turk Adalet Partisi” (KTAP), e përfaqësuar nga Arif Butuç në cilësinë e kryetarit, të paraqitur kundër vendimit te Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 412/2013 datë 13.05.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 16.05.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET** ankesa e Iniciativës politike “Kosova Turk Adalet Partisi” (KTAP) e përfaqësuar nga Arif Butuç në cilësinë e kryetarit, **si e bazuar**.

**II. ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 412/2013 datë 13.05.2013 dhe çështja kthehet në rishqyrtim.

## A r s y e t i m

Iniciativa politike “Kosova Turk Adalet Partisi” (KTAP), e përfaqësuar nga Arif Butuç në cilësinë e kryetarit, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 14.05.2013, kundër vendimit me nr. 412/2013 datë 13.05.2013 të KQZ-së, me të cilin i është refuzuar kërkesa për regjistrimin e subjektit politik.

Ankuesi në ankesën e tij ka theksuar se me rastin e marrjes së vendimit kontestues KQZ-ja, pa ndonjë arsye të bazuar dhe në kundërshtim me rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPPC), ka refuzuar regjistrimin me pretendimin se nuk është arritur shumica e nevojshme e votave për regjistrimin e një partie politike. Ndërsa thekson se nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë të KQZ-së, shtatë (7) anëtarë kanë votuar Për, dy (2) anëtarë kanë abstenuar dhe dy (2) anëtarë kanë munguar në mbledhje, propozon që të anulohet vendimi i kundërshtuar, të merren masa kompenzuese dhe të regjistrohet përfundimisht si subjekt politik iniciativa KTAP.

Si provë ka bashkangjitur rekomandimin e ZRRPC-së për KQZ dhe vendimin me nr. 412/2013 datë 13.05.2013.

KQZ-ja, në përgjigje në ankesë sërish ka cekur se arsye për refuzimin e kërkesës se së subjektit të lartpërmendur për regjistrim si parti e re është ajo se me rastin e votimit lidhur me këtë kërkesë nuk është arritur të mblidhen 2/3 të votave të nevojshme për regjistrim siç parashihet në neni 63.4 të LZP-së.

Ne arsyetimin e vendimit të KQZ-së, me nr. 412/2013 datë 13.05.2013, theksohet se: KQZ-ja nuk arriti të mblidh 2/3 e votave të nevojshme, në bazë të nenit 63.4 të LZP-së.

PZAP, pasi që analizoi pretendimet e ankuesit si dhe të gjitha shkresat e lëndës gjeti se **ankesa është e bazuar**,

Edhe pse nga rekomandimi i ZRPPC-së, i bërë për KQZ-në lidhur me plotësimin e kushteve për regjistrimin e një subjekti të ri politik del se: Iniciativa politike KTAP, i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore siç përcaktohen në Rregullën Nr.1/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, KQZ-jaka refuzuar regjistrimin e subjektit politik të lartpërmendur me arsyetim se nuk arriti të mblë 2/3 te votave të nevojshme në kuptim të nenit 63 të LZP-së, pa dhënë asnjë arsyetim të mëtejshëm për refuzim të kërkesës së lartpërmendur.

Ne nenin 5 të Rregullës Zgjedhore Nr.1/2008 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike, në mënyrë shprehimore janë paraparë arsytet për refuzimin e regjistrimit të një subjekti të ri politik, ndërsa në rastin konkret në vendimin e goditur nuk janë dhënë asnjë nga arsytet që i referohen kësaj dispozite, kështu që PZAP, gjen se tani për tani, vendimit të lartpërmendur për refuzimin e regjistrimit të këtij subjekti politik mungon baza respektivisht arsyeja juridike e paraparë në nenin 5 të rregullës së lartpërmendur.

Me rastin e rivendosjes përkritazi me kërkesën e subjektit të lartpërmendur për regjistrim KQZ-ja serish do të vlerësoi bazueshmërinë e saj, dhe nëse eventualisht gjen arsye për refuzim patjetër duhet të i referohet dispozitës së lartpërmendur të nenit 5 në të kundërtën do duhej të bëhej regjistrimi i këtij subjekti politik.

Andaj duke u bazuar në arsytet e cekura më lartë, si dhe në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 55/2013 më datën 16.05.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**

